



**QKSS**

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

# Barometri Kosovar i Sigurisë

Edicioni i pestë

Dhjetor, 2015



**National Endowment  
for Democracy**

*Supporting freedom around the world*

© Të gjitha të drejtat e rezervuara për Qendrën Kosovare për Studime të Sigurisë. Ligji mbi të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta dhe pronës intelektuale.

Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes apo të transmetohet, në asnjë formë apo me asnjë mjet elektronik, mekanik apo tjetër, pa lejen me shkrim nga botuesi. Përdorimi komercial i të gjitha raporteve të publikuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS), nuk është e lejuar pa pëlqimin me shkrim të QKSS. Ju lutem kontaktoni: info@qkss.org ose +381 38 221 420.

Perceptimet e prezantuara në këtë raport janë përmbledhje e informatave të grumbulluara nga të anketuarit dhe demonstroi vetëm atë sesi njerëzit i perceptojnë institucionet. Në asnjë mënyrë nuk është një vlerësim përfundues i cilësisë së punës së institucioneve që janë objekt i këtij studimi. Do të shërbejë si një instrument për ta për të adresuar mangësitë e mundshme, por gjithashtu si një indikator i efikasitetit të komunikimit të tyre me popullin. Pikëpamjet e paraqitura në këtë raport janë perceptimet e të anketuarve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë.

Mendimet e shprehura në këtë raport nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e National Endowment for Democracy (NKD)

### **Interpretuesit e të dhënave**

Mentor Vrajolli, hulumtues i lartë

Sofije Kryeziu, hulumtuese

### **Shqyrtimi i brendshëm:**

Florian Qehaja,

Kandidat për doktoratë, Drejtor Ekzekutiv

### **Shqyrtimi i jashtëm:**

Shpend Kursani,

Kandidat për doktoratë, Hulumtues i lartë i jashtëm

## Mirënjohje:

---

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) dëshiron t'i shprehë mirënjohje të veçantë ekipit të Barometrit Kosovar të Sigurisë të përfshirë në edicionin e hulumtimit të vitit 2015, për kontributin e tyre të shquar në hulumtimin në terren. Ekipi i BKS 2015 është përbërë nga:

### **Koordinatori i programit & Metodologjist**

Mentor Vrajolli

### **Trajnuesit e hulumtimit në terren:**

Donika Emini dhe Skender Perteshi

### **Koordinatorët e hulumtimit në terren:**

Skender Perteshi, Donika Emini, Plator Avdiu dhe Sofije Kryeziu

### **Zyrtare për futjen e të dhënave:**

Saranda Pajaziti

### **Zyrtare e lartë për komunikim:**

Tringa Naka

### **Hulumtues në terren:**

Alba Boshnjaku, Adnan Kryeziu, Agnesa Haxhiu, Agon Ahmeti, Albinë Bricori, Andi Emini, Argjira Kameri, Arian Mavriqi, Diellza Kosumi, Durim Xhemajli, Erna Buçaj, Gëzim Stavileci, Granit Hyseni, Gresa Sermaxhaj, Kastriot Grapci, Kujtim Kryeziu, Kushtrim Mustafa, Lirim Krasniqi, Malisa Zymberi, Marigona Dubovci, Milan Lazarevic, Premtim Fazlija, Rina Koleci, Rinon Arifi, Rita Nushi, Roland Sylejmani, Rron Gashi, Taulant Boshnjaku, Valëza Mjeku, Verona Kadriu, Yllza Xheladini,

### **Verifikimi i hulumtimit në terren:**

Vesë Kelmendi & Saranda Pajaziti

# Table of Contents

---

Mirënjohje:.....	3
Table of Contents.....	4
Shkurtesat .....	5
<b>Çka është Barometri Kosovar i Sigurisë? .....</b>	<b>6</b>
Kush është synimi ynë? .....	6
Ndikimi .....	6
Metodologjia.....	6
<b>KAPITULLI I .....</b>	<b>8</b>
<b>Siguria dhe drejtësia .....</b>	<b>8</b>
1.1. Besimi i qytetarëve ndaj Institucioneve të Drejtësisë dhe të Sigurisë.....	8
1.1.1. Besimi ndaj Institucioneve të Sigurisë .....	8
1.1.2. Besimi ndaj Institucioneve të Drejtësisë .....	11
1.1.3. Besimi ndaj Kuvendit dhe Qeverisë së Kosovës.....	13
1.1.4. Besimi i qytetarëve ndaj aktorëve kyç jo shtetëror .....	14
1.2. Perceptimet mbi korrupsionin.....	16
1.3. Perceptimet drejt të ardhmes së FSK-së dhe mandatit të KFOR-it dhe EULEX-it .....	17
<b>KAPITULLI II.....</b>	<b>20</b>
<b>Perceptimet e Qytetarëve drejt Kërcënimeve dhe Rreziqeve .....</b>	<b>20</b>
2.1. Kërcënimet e brendshme karshi sigurisë kombëtare.....	21
2.2. Kërcënimet e jashtme karshi sigurisë kombëtare.....	23
<b>Bibliografia.....</b>	<b>26</b>
Burimet Primare: .....	26
Burime të tjera: .....	26

## Shkurtesat

---

<b>KK</b>	Kuvendi i Kosovës
<b>EULEX</b>	Misioni Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë
<b>QK</b>	Qeveria e Kosovës
<b>QKSS</b>	Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë
<b>KFOR</b>	Forcat e Kosovës të udhëhequra nga NATO
<b>AKI</b>	Agjencia Kosovare për Inteligjencë
<b>PK</b>	Policia e Kosovës
<b>BKS</b>	Barometri Kosovar i Sigurisë
<b>FSK</b>	Forcat e Sigurisë të Kosovës
<b>NATO</b>	Organizata e Traktatit Veri Atlantik
<b>NKD</b>	Ndihma Kombëtare për Demokraci
<b>OJQ</b>	Organizata Joqeveritare
<b>IPK</b>	Inspektorati Policor i Kosovës
<b>KPS</b>	Kompani Private të Sigurimit
<b>RAE</b>	Romë, Ashkali dhe Egjiptas

---

## ÇKA ËSHTË BAROMETRI KOSOVAR I SIGURISË?

Barometri Kosovar i Sigurisë (BKS) është një program specifik i Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë i hartuar për të shërbyer si një publikim vjetor. Fokusi primar i BKS është të matë perceptimet e opinionit publik drejt institucioneve të sigurisë. Ai gjithashtu matë perceptimin publik mbi kërcënimet e brendshme dhe të jashtme të sigurisë së Kosovës. BKS shënon njërin nga iniciativat më të mëdha dhe madje të parën të hartuar, të implementuar dhe të komunikuar nga një organ lokal këshillëdhënës në Kosovë. QKSS nuk ka asnjë detyrim politik në komunikimin e të gjeturave dhe të mesazheve. Në fund, BKS është unik në qasjen e tij metodologjike, siç është adaptimi i metodave kuantitative dhe kualitative që ka për qëllim të ofrojë rezultate realiste mbi perceptimin publik drejt çështjeve të lidhura me sigurinë.

---

### Kush është synimi ynë?

BKS i drejtohet një varieteti të gjerë të aktorëve të interesuar në trendët e opinionit publik në Kosovë në fushën e sigurisë dhe të drejtësisë. Ai synon politikë bërësit në Kosovë si dhe në Ballkanin Perëndimor; organizatat ndërkombëtare në Kosovë dhe zyrat e tyre qendrore; organizatat e shoqërisë civile vendore dhe ndërkombëtare; akademinë dhe mediet.

---

### Ndikimi

Ndikimi i BKS mund të pritet të shumëfishohet në afat të mesëm për një numër arsyesh, e që përfshijnë (a) kredibilitetin e QKSS si një organ këshillëdhënës politikisht jo i lidhur dhe i pavarur; (b) meritat e QKSS në angazhimin e metodave të duhura shkencore në hulumtimin e saj; (c) rëndësinë e pronësisë lokale; dhe (d) kapacitetet profesionale në dispozicion në QKSS. Në tre botimet e kaluara, BKS ka arritur katër qëllimet e lartpërmendura.

---

### Metodologjia

Edicioni i katërt vjetor i BKS siguron një përmbledhje të besimit të qytetarëve drejt sigurisë dhe drejtësisë. Ai matë posaçërisht perceptimin publik drejt brengës së lidhur me sigurinë e brendshme dhe të jashtme si dhe çështjeve që i përkasin të ardhmes së FSK-së dhe prezencës së sigurisë ndërkombëtare.

Përgjigjet në pyetësonin e BKS janë mbledhur me anë të intervistimit të drejtpërdrejtë që është kryer në tërë Kosovën. Shumica e pyetjeve ishin të mbyllura në formën pesë pikëshe të shkallës së Likertit. Disa pyetje ishin të hapura që ua jepnin të anketuarve një mundësi të japin mendimin e tyre pa opsione të parafinuara. Mostrimi, pilotimi dhe intervistimi janë bërë nga ekipi i QKSS i përbërë nga 35 hulumtues të terrenit. Mostra kombëtare nga i cili u hartua hulumtimi, përmbante 1,070 amvisëri, duke ndjekur një mostër reprezentative të popullatës mbi moshën 18 vjeçare në Kosovë. Ndarja etnike e të anketuarve ishte: 88.4 përqind shqiptar të Kosovës, 7.7 përqind serb të Kosovës, dhe 3.9 të tjerë (nga ta, 1.4 përqind turq, 0.6 boshnjak, 1.0 përqind RAE dhe të tjerët përfshijnë goranë, kroatë dhe malazezë).

Korniza e mostrës ishte e bazuar mbi kodet telefonike të rajoneve, e cila ka përfshirë 7 rajonet në vijim: Ferizaj, Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë, Pejë, Prishtinë dhe Prizren. Faza e parë e grupimit gjeografik është bazuar në Raportin e Regjistrimit të Popullsisë të vitit 2012 të Kosovës, faza e dytë përfshinë grupimin e mostrave sipas zonave komunale me mostër të stratifikuar fshat/qytet sipas numrit të familjeve. Faza e fundit ndjek metodën e mostrës së rastit duke shfrytëzuar metodën e ditëlindjes më të afërt. Mostrimi i rastit siguron që secili banor në Kosovë të ketë një qasë të barabartë për t'u zgjedhur për një intervistë. Me mostrën e përdorur për këtë studim, rezultati i projektit të hulumtimit, pasqyron imazhin e trendëve në qëndrime dhe perceptime, në mesin e tërë popullatës së rritur në Kosovë në përgjithësi. Margjina e gabimit është 3 përqind me një interval të konfidencës prej 95 përqind.

Para fillimit të punës në terren, një pilot intervistë u realizua në fillim të tetorit 2015, për të testuar realizueshmërinë e pyetësorit. Ekipi hulumtues më pas raportoi se pilot intervista ishte e suksesshme, dhe nuk është hasur në probleme me pyetjet e bëra të anketuarve. Të gjitha intervistat janë kryer nga 21 deri më 29 tetor 2015. Përpunimit i të dhënave dhe analiza janë bërë duke përdorur softuerin SPSS.

Perceptimet e paraqitura në këtë raport janë një përmbledhje e informacioneve të mbledhura nga të anketuarit dhe kjo vetëm tregon se si njerëzit i perceptojnë këto institucione. Prandaj, ky raport nuk paraqet një vlerësim përfundimtar të cilësisë së punës së institucioneve që i janë nënshtruar këtij studimi. Qëllimi i QKSS-së me këtë botim është vetëm të interpretojë perceptimet, apo me fjalë të tjera, "çfarë thuhet" nga qytetarët e Kosovës në fushat e mbuluara nga pyetësori. Ekipi i QKSS nuk merr përgjegjësinë për rezultatin e të dhënave, veçanërisht në qoftë se ky shkakton ndonjë reagim në mesin e aktorëve specifik. Ekipi mbetet i gatshëm ta bëjë transparent të gjithë procesin dhe metodologjinë e përdorur, nëse ndonjë subjekt është i interesuar në të.

# KAPITULLI I

## SIGURIA DHE DREJTËSIA

Lista e institucioneve që janë marrë në konsideratë nga kjo anketë është i ngjashëm me ato të edicioneve të mëparshme. Në të janë përfshirë: Policia e Kosovës (PK), Forcat e Sigurisë së Kosovës (FSK), Agjencia e Kosovës për Inteligjencë (AKI), Qeveria, misioni ushtarak i NATO-s në Kosovë (KFOR), Misionin Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX), kompanitë private të sigurimit (KPS-të), Prokuroria, Gjykatat, organizatat jo-qeveritare (OJQ), institucionet fetare dhe mediet. Në ndërkohe Kuvendi i Kosovës (KK) dhe Inspektorati Policor i Kosovës (IPK) janë debutues të rinj të hulumtimit të BKS. Derisa objektiva primare janë institucionet e sigurisë, BKS e shqyrton sektorin e sigurisë nga perspektiva holistike, ku të gjitha institucionet e tjera publike kanë rëndësi për mjedisin e sigurisë.

Ky paragraf siguron interpretimin e rezultateve të BKS të bazuara në indikatorët në vijim: besimi i qytetarëve drejt sigurisë dhe drejtësisë; ndërveprimi i qytetarëve me institucionet e sigurisë dhe të drejtësisë, dhe perceptimi i tyre mbi korrupsionin. Për herë të parë, ky botim siguron të dhënat mbi perceptimet publike për transformimin e Forcës së Sigurisë të Kosovës; tërheqjen e prezencës ndërkombëtare të sigurisë, gjegjësisht të KFOR-it dhe EULEX-it.

### 1.1. Besimi i qytetarëve ndaj Institucioneve të Drejtësisë dhe të Sigurisë

Matja e besimit të qytetarëve ndaj institucioneve të sigurisë dhe të drejtësisë paraqet një nga objektivat më të rëndësishëm të programit të Barometrit Kosovar të Sigurisë (BKS). QKSS ka kategorizuar rezultatet e besimit ndaj institucioneve të sigurisë dhe të drejtësisë në katër grupe: institucionet e sigurisë; institucionet e drejtësisë; Kuvendi dhe Qeveria e Kosovës; dhe aktorët jo shtetëror.

#### 1.1.1. Besimi ndaj Institucioneve të Sigurisë

Në mesin e institucioneve të sigurisë të matura nga BKS në këtë vit përfshinë: AKI, FSK, KFOR, IPK, PK dhe KPS. Në mesin e tyre, Institucionet më të besuara të sigurisë rezultuan të jenë: FSK (me 69%) dhe KFOR (me 65%), që pason PK (me 56%). Në të vërtetë, këto institucione jo vetëm që rezultuan si më të besueshmet në kuadër të institucioneve të sigurisë, por rezultati tregoi se gjithashtu ka edhe një ngritje në besimin ndaj tyre, në krahasim me rezultatet e Edicioneve të viteve të kaluara të BKS. Rasti më i dukshëm është PK që sipas rezultateve të këtij edicioni të BKS, përqindja totale e të anketuarve që u përgjigjën se i besojnë këtij institucioni është ngritur prej 10 përqind të pikave krahasuar me vitin e kaluar.<sup>1</sup> Në ndërkohë, bazuar në observimet nga hulumtimi në terren, argumentet kryesore, në të cilat të anketuarit i kanë bazuar perceptimet

<sup>1</sup> Keni parasysh se Hulumtimi është realizuar para protestave të fundit të dhunshme që ndodhën në nëntor 2015



e tyre mbi policinë ishin: arrestimi i individëve të lidhur me grupet ekstremiste<sup>2</sup>, arrestimet për korrupsion dhe krim të organizuar<sup>3</sup>; si dhe viktimizimi i perceptuar i tyre gjatë protestave që ndodhën në Prishtinë gjatë fillimit të vitin 2015<sup>4,5</sup>.

Në anën tjetër, ngritja e besimit ndaj FSK dhe KFOR krahasuar me edicionin e fundit të BKS ishte më modest, me rreth 3% të pikëve.<sup>6</sup> Kur i referohemi FSK-së, të anketuarit zakonisht tërhoqën një linjë ndërmjet këtij institucioni dhe transformimit të tyre të pritur në Forca të Armatosura të Kosovës<sup>7</sup>. Në ndërkohë, besimi i të anketuarve ndaj KFOR-it ishte i lidhur, si zakonisht, me rolin e tij në përpjekjet paqeruajtëse të periudhës menjëherë pas pasluftës, dhe jo me rolin e tij të tanishëm.<sup>8</sup>

Përveç këtyre tre institucioneve më të besueshme, rezultatet e hulumtimit gjithashtu kanë treguar se as besimi ndaj IPK nuk është i ulur, respektivisht, 40% i të anketuarve kanë deklaruar se i besojnë IPK-së, krahasuar me 30% të atyre që kanë deklaruar të kundërtën. IPK në mënyrë të vazhdueshme ka qenë i nënshtruar akuzave të ndryshme nga aktorë të ndryshëm, duke përfshirë mediet, e jithashtu, nuk është një nga institucionet në vijë të parë të frontit sa i përket sundimit të ligjit, që do t'ua mundësonte qytetarëve të formojnë perceptimet dhe mendimet e tyre nga përvojat direkte personale. Prandaj, duke pasur parasysh se kjo është hera e parë që perceptimet e qytetarëve janë marrë lidhur me IPK dhe se nuk mund të tërhiqen analiza krahasuese, mund të arrihet në përfundim se perceptimi publik mbi këtë institucion anon më tepër drejt anës pozitive.

Të dhënat e hulumtimit nga edicioni aktual i BKS tregojnë se besimi ndaj KPS-ve qëndron në rreth 35%. Çka duhet të vërehet kur bëhet fjalë për aktorët privat të sigurisë është se qytetarët vazhdojnë të perceptojnë sektorin e sigurisë nga këndvështrimi tradicional; prandaj, ata nuk i kushtojnë shumë vëmendje rolit të KPS-ve kur bëhet fjalë për ushtrimin e detyrave të sigurisë publike në përgjithësi.<sup>9</sup>

Në fund, me vetëm 14% e të anketuarve që kanë deklaruar se kanë besim në AKI, ky institucion vazhdon të qëndrojë si një nga institucionet e sigurisë më pak të besuara në Kosovë. Për më tepër, rreth 43% e të anketuarve kanë deklaruar se nuk i besojnë AKI-së. Ky rezultat është befasues për vet faktin se AKI gjatë fillimit të vitit 2015 ju kishte nënshtruar dryshimeve të rëndësishme së stukturës udhëheqëse të saj. Në fakt, është me rëndësi të përmendet se që nga ndërrimet e lartpërmendura në menaxhment të AKI-së që kanë ndodhur, nuk ka pasur referenca negative të shprehura në publikisht lidhur me këtë institucion. Përkundrazi, nga struktura udhëheqëse e re janë iniciuar hapa tejet pozitive të cilat logjikisht do të duhej të kishin kontribuar në përmirësimin e reputacionit të këtij institucioni. Megjithatë, duket se stereotipat ndaj AKI-së të ngulitur në mesin e popullatës, si rezultat i skandaleve që janë paraqitur gjatë viteve të mëparshme, po vazhdojnë ta dëmtojnë imazhin e këtij institucioni. Në anën tjetër, edhe mandati ligjor që ka AKI e që e obligon atë që punët e saj të kryej në mënyrë jo-transparente shpesh ndikon që rezultatet e punës së kësaj Agjencie të i atribuohen PK. Mirëpo, rezultatet kritike si kjo, gjithsesi duhet të

2 Policia e Kosovës arreston 5 persona të dyshuar për terrorizëm, <http://www.zeriamerikes.com/content/kosovo-police-terrorism/2857719.html>

3 Aksion i Madh Policor: 39 Policë dhe 9 Doganiere arrestohen për korrupsion dhe ryshfet, <http://lajmi.net/aksion-i-madh-policor-arrestohen-39-police-dhe-9-doganiere-per-mitmarrje-dhe-korrupsion/>

4 Përlëshje të dhunshme ndërmjet protestuesve dhe policisë në Prishtinë, 27 janar 2015, <http://www.reporter.al/galeri/perleshje-te-dhunshme-mes-protestuesve-dhe-policise-ne-prishtine-fotogaleri/>

5 Informata të mbledhura nga Fokus grupi i organizuar nga QKSS me hulumtuesit nga terreni më 16 nëntor 2015


6 Shih Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) Edicioni i Barometrit Kosovari të Sigurisë 2014, lansuar në dhjetor 2015

7 Informata të mbledhura nga Fokus grupi i organizuar nga QKSS me hulumtuesit nga terreni më 16 nëntor 2015

8 Po aty.

9 Po aty.

shërbejnë si përkujtues për AKI-në për nevojën e saj imediate që ta ri-shqyrtojë qasjen e saj të komunikimit me publikun, me qëllim që ta rindërtojë besimin e vet me qytetarët.<sup>10</sup>




la vlen të përmendet se perceptimet mbi besimin kryesisht varen nga burimet e informatave, të cilat zakonisht ndikojnë në opinionet e qytetarëve. Për këtë arsye, përveç matjes së besimit ndaj institucioneve të sigurisë, BKS gjithashtu ka matur edhe shpeshësinë e kontakteve që qytetarët kanë pasur me këto institucione. Qëllimi këtu është të identifikohet nëse perceptimet ndaj këtyre institucioneve të sigurisë ishin krijuar bazuar në përvoja personale apo bazuar në vështrime të tyre pasive. Çka është me rëndësi të nënvizohet këtu është se me përjashtim të PK, sipas rezultateve të hulumtimit, perceptimet e qytetarëve ndaj të gjitha institucioneve tjera të sigurisë ishin formuar kryesisht në bazë të vështrimeve të tyre pasive e jo me anë të kontakteve të tyre direkte.

Në fakt, PK është i vetmi institucion, i cili ka rezultuar të ketë qenë i kontaktuar drejtpërdrejtë nga shumica e të anketuarve (58%), që do të thotë se PK ishte institucioni i sigurisë që më së shumti ishte në kontakt të drejtpërdrejtë me qytetarët. Kjo nuk është për t'u befasuar, duke pasur parasysh natyrën e punës së policisë. Dhe ky kontakt i drejtpërdrejtë mund të jetë ajo që i jep një bazë më racionale perceptimit të të anketuarve ndaj PK, e që nuk ishte gjithmonë rast i njëjtë me institucionet tjera të sigurisë që janë matur nga BKS.

Institucioni i dytë më së shpeshti i kontaktuar del të jetë KPS-të me 35% i të anketuarve të cilët kanë pohuar se kanë pasur kontakt të drejtpërdrejtë me këto institucione private. Në ndërkohë, KFOR-i dhe FSK, që kanë rezultuar të jenë institucionet më të besueshme e që janë kontaktuar vetëm nga 23% dhe 21% nga ana e të anketuarve. IPK gjithashtu ka rezultuar të jetë kontaktuar vetëm nga 15% e të anketuarve. Përfundimisht, AKI ishte institucioni më së paku i kontaktuar me vetëm 2% i të anketuarve që pohuan se kanë kontaktuar këtë institucion. Sidoqoftë, duhet

10 Po aty

të thuhet që fakti se AKI është institucioni më pak i kontaktuar, nuk mund të merret si negative. Në të vërtetë, kjo është mu natyra e këtij institucioni që i jep bazë për t'u listuar në fund të këtyre institucioneve kur bëhet fjalë për kontaktin e drejtpërdrejtë me qytetarët.



### 1.1.2. Besimi ndaj Institucioneve të Drejtësisë

Edhe në këtë vit sektori i drejtësisë vazhdon të jetë objekt i kritikave dhe pakënaqësive të shprehura nga qytetarët. Këtë e konfirmojnë edhe rezultatet e edicionit aktual të BKS, të cilat tregojnë se besimi ndaj institucioneve të drejtësisë siç janë gjykatat, prokuroria dhe EULEX<sup>11</sup> vazhdon të jetë tejtejet i ulët. Më saktësisht, rezultatet e hulumtimit tregojnë se 54% e të anketuarve nuk i besojnë EULEX-it, që do të thotë se nga të gjitha institucionet që janë matur këtë vit, vetëm KK dhe QK kanë pasur rezultate më të vogla. Në të vërtetë, krahasuar me edicionin e kaluar, rezultatet tregojnë se këtë vit mosbesimi ndaj EULEX-it është ngritur me 10% të pikëve. Kjo ngritje shënon gjithashtu trendin e besimit negativ më të lartë të matur nga ky BKS 2015.<sup>12</sup> Si rezultat i rënies masive në besim, EULEX-i është radhitur, për herë të parë, nën prokurorinë dhe gjykatat vendore, kur bëhet fjalë për perceptimin e qytetarëve dhe besimin e tyre ndaj institucioneve të drejtësisë. Perceptimet e të anketuarve mbi EULEX-in ishin kryesisht të bazuara në besimin e tyre se këtij misioni i mungon efikasiteti në luftën kundër korrupsionit në Kosovë. Për më tepër ata i arsyetuan perceptimet e tyre edhe me dyshimeve për korrupsionit që u paraqitën në fund të vitit 2014 dhe në fillim të vitit 2015, lidhur me përfshirjen e mundshme të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it që punojnë për këtë mision, në aferat korruptive të mëdha.<sup>13,14</sup>

11 Këtë vit EULEX është futur me qëllim në mesin e institucioneve të drejtësisë duke pasur parasysh se pjesa më e madhe e kompetencave të mbetura të këtij misioni tani janë të përqendruara në sektorin e drejtësisë.


12 Shih Edicionin e Rregullt Vjetor të Barometrit Kosovari të Sigurisë për 2014 të publikuar nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS),

13 Aferat e Dyshuara Korruptive në EULEX më tej zbehin besimin e qytetarëve te institucionet e drejtësisë, DW, nëntor 2015, <http://www.dw.com/sq/dyshimet-p%C3%ABr-aferta-korruptive-n%C3%AB-eulex-zbehin-besimin-te-organet-e-drejt%C3%ABsis%C3%AB-n%C3%AB-kosov%C3%AB/a-18038448>

14 Informatat e grumbulluara nga Fokus grupi i organizuar nga QKSS me hulumtuesit nga terreni më 16 nëntor 2015


Në anën tjetër, qytetarët ishin kritik gjithashtu edhe kur bëhet fjalë për institucionet e drejtësisë vendore. Sipas rezultateve të hulumtimit, mbi 51% e të anketuarve kanë deklaruar se ata nuk u besojnë gjykatave të Kosovës, ndërsa 40% kanë deklaruar se nuk i besojnë prokurorisë së Kosovës. Rezultatet e hulumtimit tregojnë se është bërë përmirësim shumë i limituar në besimin e qytetarëve ndaj institucioneve vendore. Krahasuar me edicionin e kaluar të BKS, numri i atyre të cilët kanë shprehur mosbesim ndaj gjykatave, është ngritur pak, ndërsa besimi ndaj prokurorisë është ngritur për 5% të pikëve. Çka ia vlen të vërehet, sidoqoftë është se qytetarët shpesh gabimisht bëjnë lidhjen e gjyqësorit vetëm me gjykatat, duke e lënë prokurorinë, në një masë të madhe, jashtë vështrimit të opinionit publik.

**Figura 3: Besueshmëria e qytetarëve ndaj institucioneve të drejtësisë (BKS15)**



Në anën tjetër, rezultatet e hulumtimit të BKS gjithashtu tregojnë se kontakti i qytetarëve me institucionet e drejtësisë është relativisht i ulët. Megjithatë, kjo nuk duhet patjetër të merret si indikator negativ, pasi që jo të gjithë qytetarët janë të obliguar të kenë kontakte direkte me institucionet e drejtësisë apo anasjelltas. Sipas BKS, vetëm 29% e të anketuarve kanë pohuar të kenë pasur kontakte direkte me gjykatat; 14% kanë pohuar të kenë pasur kontakte me prokurorinë; ndërsa 7% i tyre kanë pohuar të kenë pasur kontakt me EULEX-in. Ia vlen të nënvizohet se perceptimet e qytetarëve ndaj institucioneve të drejtësisë janë të bazuara kryesisht në diskursin mbizotërues publik dhe vëzhgimet e tyre të përgjithshme në lidhje me sundimin e ligjit në Kosovë.

**Figura 4: Shpeshtësia e kontateve të qytetarëve me institucionet e drejtësisë (BKS15)**




### 1.1.3. Besimi ndaj Kuvendit dhe Qeverisë së Kosovës

Shikuar nga pikëpamja e sigurisë dhe e drejtësisë, Kuvendi i Kosovës (KK) dhe Qeveria e Kosovës (QK) janë ndër institucionet që kanë hise të rëndësishme në këtë sektor. Rëndësia e tyre është si strategjike ashtu dhe operacionale - që do të thotë se ata nuk janë vetëm përgjegjës për të përcaktuar politikat e sigurisë dhe drejtësisë në Kosovë, por nëse i vështrojmë këto politika nga këndvështrimi i 'sigurisë njerëzore' atëherë roli i tyre është i rëndësishëm edhe në aspektin operativ.

Mirëpo, pavarësisht rolit të rëndësishëm të tyre, rezultatet e anketës tregojnë se besimi i qytetarëve si ndaj Kuvendit ashtu edhe ndaj Qeverisë janë në gjendje kritike. Më saktësisht, 65% e të anketuarve kanë deklaruar se ata nuk i besojnë Kuvendit të Kosovës, i cili është në nivelin më alarmant të mosbesimit në mesin e të gjitha institucioneve të matura nga ky edicioni i BKS. Ngjashëm, 61% e të anketuarve kanë deklaruar se nuk i besojnë as Qeverisë së Kosovës, që e bën institucionin e dytë më të pabesueshëm në mesin e institucioneve që matura nga BKS.

Vëzhgimet nga hulumtimet në terren, gjatë intervistimit treguan se perceptimet e të anketuarve janë formësuar kryesisht nga vëzhgimi i zhvillimeve të përgjithshme politike gjatë dy viteve të fundit. Pra, perceptimet e tyre nuk janë të bazuara vetëm në bllokimin e fundit politik në KK. Përkundrazi, ata gjithashtu ia atribuuan perceptimet e tyre zhvillimeve të vitit të kaluar, duke përfshirë krizën e krijuar para zgjedhjeve të vitit të kaluar, si dhe atyre pas zgjedhjeve të Qershorit 2014, të cilat ende duket të kenë ndikim në zhvillimet e përditshme politike. Në fakt, këtë e tregon edhe rezultati i edicionit 2014 të BKS, ku niveli i besimit të qytetarëve ndaj Qeverisë së Kosovës ishte gjithashtu i ulët.


**Figura 5: Besueshmëria e qytetarëve ndaj Kuvendit dhe Qeverisë së Kosovës (BKS15)**



Nga ana tjetër, është e rëndësishme të përmendet se rezultatet e anketës tregojnë jo vetëm se qytetarët ndajnë një nivel shumë të ulët të besimit ndaj Kuvendit të Kosovës dhe Qeverisë së Kosovës, por ato gjithashtu tregojnë se ata në përgjithësi nuk ndejnë ndonjë ndikim domethënës të këtyre dy institucioneve në jetën e tyre. Më saktësisht, vetëm 9% e të anketuarve (ose përafërsisht 1 në 11) deklaruan se kanë pasur kontakte me përfaqësuesit e tyre të zgjedhur në Kuvendin e Kosovës. Në mënyrë të ngjashme, vetëm 10 për qind e të anketuarve (ose 1 në 10) kanë deklaruar se ata kanë qenë të kontaktuar nga ky institucion. Përveç kësaj, siç është dëshmuar nga hulumtuesit në terren, të anketuarit zakonisht kanë akuzuar përfaqësuesit e tyre në Kuvendin e Kosovës dhe në Qeverinë e Kosovës se kanë qenë në kontakt me qytetarët vetëm gjatë fushatave elektorale.<sup>15</sup>

15 Informatat e grumbulluara nga Fokus grupi i organizuar nga QKSS me hulumtuesit nga terreni më 16 nëntor 2015

**Figura 6: Shpeshësia e kontakteve të qytetarëve me Kuvendin dhe Qeverinë e Kosovës (BKS15)**



#### 1.1.4. Besimi i qytetarëve ndaj aktorëve kyç jo shtetëror

Edicioni i tanishëm i BKS vazhdoi të kushtojë vëmendje edhe aktorëve jo-shtetërorë, siç janë shoqëria civile, mediet dhe institucionet fetare të cilët operojnë në Kosovë e që, ndër të tjera, mbajnë një rol të rëndësishëm kur është fjala për sigurinë, drejtësinë, dhe vlerat themelore morale të shoqërisë në Kosovë. Në të vërtetë, gjatë viteve të fundit, këto institucione kanë rritur ndjeshëm rëndësinë e tyre si aktorë në sektorin e sigurisë dhe të drejtësisë në Kosovë. Si rezultat i kësaj, botimet e tanishme të BKS do të publikojnë rezultatet e besimit të qytetarëve ndaj këtyre institucioneve.


Rezultatet e anketës tregojnë se institucionet fetare vazhdojnë të jenë më të besuara në krahasim me shoqërinë civile dhe mediet. Rreth 56% e të anketuarve kanë deklaruar se ata u besojnë institucioneve të tyre përkatëse fetare, krahasuar me 22% që kanë deklaruar se ata nuk u besojnë atyre, që, si aspekt krahasues, është pothuajse identik me rezultatet e hulumtimit të vitit të kaluar. Në ndërkohë, duke pasur parasysh se Kosova është e karakterizuar nga tre konfesionet kryesorë fetare, ia vlen të vërehet se të anketuarit që i përkasin konfesioneve të ndryshme fetare kanë shkallë të ndryshme të besimit në këto institucione. Për shembull, 76% e atyre që i përkasin konfesionit të krishterë ortodoks (zakonisht në mesin e serbëve) deklaruan të kenë besim duke aluduar në Patriarkanën e Kishës Ortodokse Serbe, duke pasur nga katolikët, 63% e të cilëve deklaruan se i besojnë Administratës së Kishës Apostolike të Kosovës, ndërsa 51% e të anketuarve myslimanë (që ishin shumica dërrmuese e të anketuarve të përgjithshëm) kanë deklaruar se i besojnë Bashkësisë Islame të Kosovës. Argumenti kryesor pse të anketuarit që i përkasin komunitetit ortodoks (shumica e të cilëve ishin serbë) treguan kaq shumë besim ndaj përfaqësuesve të tyre fetarë mund të jetë e lidhur me rëndësinë që Kisha Ortodokse Serbe i kushton Kosovës në agjendën e saj e cila mban tone të theksuara nacionaliste. Ndërkohë, argumentet kryesore pse të anketuarit e besimit mysliman janë më pak të predispozuar për të shfaqur besimin ndaj institucioneve të tyre përfaqësuese fetare është e lidhur me mos-parandalimin në nivel të duhur të depërtimit të lëvizjeve ekstremiste në Kosovë të cilat sipas tyre kanë për qëllim keqpërdorjen e fesë së të tyre për agjenda të caktuar politike.

Niveli i besimit në shoqërinë civile duket se është rritur në krahasim me rezultatet e mëparshme. Rezultatet e anketës së edicionit të fundit të BKS tregojnë se 45% e të anketuarve u besojnë organizatave të shoqërisë civile, që është 13% të pikëve më i lartë se një vit më parë<sup>16</sup>. Megjithatë,

<sup>16</sup> Barometri Kosovari i Sigurisë 2014, Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, dhjetor 2014

opinionit publik ka vazhduar të ketë më pak besim në media. Vetëm 29% e të anketuarve kanë deklaruar se u besojnë medieve, ndërsa 32% deklaruan të kundërtën. Kur është fjala për perceptimet e tyre ndaj medieve, referencë e tyre kryesore është se ato janë të politizuara, gjithashtu të orientuara në biznes, dhe të anketuarit ndajnë mendimin se atyre u mungon objektiviteti në raportimet e tyre. Përveç kësaj, në mesin e argumenteve të përmendura ka qenë edhe mungesa e profesionalizmit i demonstruar nga një numër i caktuar i gazetarëve.

**Figura 7: Besueshmëria e qytetarëve ndaj akterëve jo-shtetëror (BKS15)**




BKS ka matur edhe shpeshtësinë e kontaktit të qytetarëve me këto tre institucione. Rezultatet e anketës tregojnë se institucionet më të kontaktuara kanë rezultuar të jenë OJQ-të, me 53% e të anketuarve, duke pohuar se kanë pasur kontakt me ta. Sipas studiuesve në terren, të anketuarit theksuan se kontaktet e tyre me OJQ-të erdhën kryesisht përmes sondazheve të kryera nga këto organizata. Në të vërtetë, është gjithashtu shumë e rëndësishme të përmendet se një numër i konsiderueshëm i të anketuarve konsiderojnë sondazhet si një mundësi për ta për të shprehur shqetësimet e tyre socio-ekonomike. Në ndërkohë, të anketuarit kanë përmendur gjithashtu se kanë pasur kontakte me OJQ-të përmes aktiviteteve të lidhura me komunitetin dhe projektet e ndërmarra nga OJQ-të, ku janë të angazhuar në cilësi të ndryshme.<sup>17</sup>

Kur bëhet fjalë për institucionet fetare, vetëm 40% e të anketuarve kanë deklaruar se kanë pasur kontakt me institucionet e tyre përkatëse. Me këtë përqindje, ata kryesisht i janë referuar imamëve apo priftërve të tyre më të afërt, që do të thotë se kontaktet me strukturat më të larta të komuniteteve të tyre fetare ishin më pak të shpeshta. Në fund, sipas rezultateve të hulumtimit të BKS, vetëm 23% e të anketuarve kanë deklaruar të kenë pasur kontakte direkte me media. Në fakt, kjo është një gjetje shumë interesante. Kjo tregon se qytetarët nuk konsiderojnë shikimin e TV, dëgjimin e radios, apo leximin e gazetave si kontakt direkt me media.

17 Po aty

**Figura 8: Shpeshtësia e kontateve të qytetarëve me akterët jo-shetëror (BKS15)**



## 1.2. Perceptimet mbi korrupsionin


Edhe ky Edicion i BKS ka vazhduar të grumbulloj perceptimet e qytetarëve drejt korrupsionit në institucionet e sigurisë dhe të drejtësisë në Kosovë. Lista e institucioneve të matura është: Policia e Kosovës, Forcat e Sigurisë të Kosovës, Gjykatat, Prokuroria, Institucionet Komunale dhe Qeveria.

Në bazë të rezultateve, qytetarët kryesisht janë të predispozuar që të mendojnë se institucionet e sigurisë janë më pak të korruptuara krahasuar me institucionet e drejtësisë, administratën komunale, apo Qeverinë. Më saktësisht, rreth 73% e të anketuarve kanë deklaruar se Forcat e Sigurisë të Kosovës nuk janë të prekura nga korrupsioni, krahasuar me 7% e të anketuarve që kanë deklaruar të kundërtën. Ky është një perceptim i jashtëzakonshëm pozitiv, posaçërisht kur krahasohet me institucionet tjera të shqyrtuara në këtë hulumtim. Në fakt, ky perceptim është në mënyrë signifikante më pozitiv gjithashtu kur krahasohet me Policinë e Kosovës, që rezultoi të jetë perceptuar si institucioni i dytë në listë më pak i korruptuar. Prandaj, vetëm rreth 41% e të anketuarve kanë deklaruar se PK nuk është e korruptuar, krahasuar me 27% të atyre që kanë deklaruar të kundërtën, ndërsa 28% të tjerë të anketuar kanë deklaruar se disi është e korruptuar.

Për dallim nga institucionet e lartpërmendura të sigurisë, si institucionet e drejtësisë ashtu dhe institucionet ekzekutive janë perceptuar si institucione shumë të korruptuar. Më saktësisht, 62% e të anketuarve kanë deklaruar se gjykatat janë të korruptuara, si edhe 58% deklaruan se prokuroria është e korruptuar. Në anën tjetër, 64% deklaruan se Qeveria e Kosovës është e korruptuar, ndërsa 54% deklaruan se institucionet komunale janë të korruptuara gjithashtu. Perceptimet për korrupsionin janë të ndërlidhura me perceptimin mbi besimin, sepse të anketuarit kanë shprehur mendime të qëndrueshme mbi besimin dhe korrupsionin.




**Figura 9: Niveli i korrupsionit në institucionet e sigurisë dhe drejtësisë sipas perceptimeve të qytetarëve (BKS15)**




### 1.3. Perceptimet drejt të ardhmes së FSK-së dhe mandatit të KFOR-it dhe EULEX-it

Pavarësisht përfundimit të periudhës së tranzicionit sa i përket pavarësisë së mbikëqyrur, shteti i Kosovës edhe më tutje pritet të i nënshtrohet reformave përblyëse në sektorin e sigurisë të cilat duhet të zhvillohen nën dritën e nevojave të paraqitura në terren. Gjatë viteve të fundit ka pasur diskutime të vazhdueshme në lidhje me të ardhmen e Forcës së Sigurisë së Kosovës. Debate të njëjta ka pasur edhe në lidhje me të ardhmen e Misionit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX), dhe në një masë më të vogël, të misionit të KFOR-it në Kosovë.

Sa i përket të ardhmes së FSK-së, deri në 88% e të anketuarve mbështetën propozimin e qeverisë për transformimin e këtij institucioni në Forcat e Armatosura të Kosovës. Kjo është ndër bindjet më të përqaftuara nga ana e qytetarëve të Kosovës. Të anketuarit kanë bazuar perceptimin e tyre mbi nevojën e Kosovës që të ketë kapacitetet e saj të mbrojtjes dhe gjithashtu kanë theksuar rëndësinë emblematike që ka ky transformim për kompletimin e shtetësisë.

**Figura 10: Perceptimet e qytetarëve në lidhje me të ardhmen e FSK-se (BKS15)**

Edhe perceptimet në lidhje me vazhdimin e mandatit të KFOR-it të anketuarit i lidhin me zhvillimet që kanë të bëjnë me të ardhmen e FSK-së. Sa më pak kapacitete vendore në fushën e mbrojtjes aq më shumë kërkesa për vazhdimin e mandatit të KFOR-it. Mirëpo megjithse ekziston përkrahje e vazhdueshëm nga ana e qytetarëve për misionin e KFOR-it, perceptimi publik nuk reflekton një mbështetje për prezencë të palimituar në aspektin kohor. Përkundra, opinioni më i shpeshtë i publikut del të jete se KFOR duhet të tërheqjen gjatë 3-5 vites e ardhshme (42.5%). Vetëm 5.8% që kërkon tërheqjen e saj vitin e ardhshëm (në vitin 2016) ndëkohë që një përqindje e vogël mendon se ky mision tanimë është dashur të tërhiqet (12%). Në anën tjetër 37.5% besojnë se misioni kurrë nuk duhet të tërhiqet. Kategoria e fundit e të anketuarve e bazojnë mendimin e tyre në sfidat e vazhdueshme të normalizimit të marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë dhe perceptimin se ky i fundit përbën një kërcënim të sigurisë ndaj Kosovës.<sup>18</sup>


**Figura 11: Perceptimet e qytetarëve në lidhje me të ardhmen e misionit të KFOR (BKS15)**

Sikurse për KFOR, e njëjta pyetje të anketuarve ju është shtruar edhe për të ardhmen e EULEX-it. Këtu, megjithatë, përgjigjet ishin krejt të ndryshme; shumica e të anketuarve ishin në favor të

<sup>18</sup> Fokus grup me hulumtuesit nga terreni, i organizuar për të diskutuar mbi perceptimet e të anketuarve. Fokus grupi u organizuar nga QKSS më 16 nëntor 2015.

largimit të EULEX-it nga Kosova. Rreth 37% e të anketuarve kanë deklaruar se EULEX-i tanimë duhet të jetë tërhequr, ndërsa një tjetër 6% deklaruan se ky mision duhet të largohet vitin e ardhshëm. Përkatesisht, në qoftë se shtohet, kjo do të thotë se 43% e kosovarëve janë në favor që ky mision ta braktisë Kosovën shumë shpejt, ndoshta në vitin 2016, kur mandati i misionit praktikisht përfundon. Në anën tjetër, deri në 33% mendonin se EULEX-i ende ka për të bërë punë në Kosovë, duke theksuar se EULEX-i duhet të qëndrojë në Kosovë edhe për 3 deri në 5 vite. Vetëm 13% deklaruan se ky mision nuk duhet të largohet nga Kosova.

**Figura 12: Perceptimet e qytetarëve në lidhje me të ardhmen e misionit të EULEX (BKS15)**



## KAPITULLI II

### PERCEPTIMET E QYTETARËVE DREJT KËRCËNIMEVE DHE RREZIQEVE

Qëllimi i këtij kapitulli është të adresojë shqetësimet e qytetarëve në lidhje me rreziqet dhe kërcënimet kryesore që rëndojnë sigurinë kombëtare të Kosovës. Ky vit u karakterizua nga një seri ngjarjesh që dëshmuar se Kosova ballafaqohet me joqëndrueshmëri politik, sociale dhe fetare, e të cilat lanë gjurmë në opinionin publik në përgjithësi sa i përket sigurisë kombëtare në vend. Ky kapitull synon të shqyrtojë shkallën në të cilën këto zhvillime kanë ndikuar perceptimet e qytetarëve. Siç ishte rasti edeh me edicionin e mëparshëm të BKS, fillimisht të anketuarit ju nënshtuan një pyetje të hapur më të cilën ju mundësua atyre që të i identifikojnë rreziqet dhe kërcënimet kryesore ndaj sigurisë kombëtare. Kjo është bërë kryesisht jo vetëm për të përjashtuar mundësinë e ndikimit të mendimeve të tyre, por edhe të ketë një kontribut cilësor që do të na ndihmonte të kuptojmë më mirë përgjigjet e ofruara nga të anketuarit, kur është fjala për pyetjet e mbyllura.

Përgjigjet nga kjo pyetje e hapur dolën të jenë në trend të ngjashëm me opinionin e të anketuarve në lidhje me rreziqet dhe kërcënimet e jashtme të parashtruara me anë të pyetjeve të mbyllura. Qytetarët identifikuan tri kategori të problemeve: Sfidat politike, ekonomike dhe të sigurisë. Sa i përket rreziqet dhe kërcënimet e brendshme, shumica e të anketuarve vlerësuan se korrupsioni i përket të tre kategorive dhe është më brengosësja. Gjithashtu, edhe paqëndrueshmërinë aktuale politike dhe krizat, duke përfshirë mosmarrëveshjet midis partive politike, mungesën e konsensusit të brendshëm politik dhe protestat e dhunshme u përmendën shpesh nga të anketuarit. Grupi tjetër i kërcënimeve më të shprehura të brendshme janë ato që lidhen me faktorët ekonomikë, duke filluar nga papunësia, moszhvillimi ekonomik dhe mungesa e mundësive. Ndërsa grupi i kërcënimeve më të përmendura nga ana e të anketuarve ishin ato që lidhen me sigurinë - kur është fjala për brengat e qytetarëve rreth nivelit të lartë të krimit të organizuar pasuar nga ekstremizmi i dhunshëm me tendencë keqpërdorimin e feve për agjenta politike. Çështje të tjera më pakt të përmendura përfshijnë një sërë temash të tilla si: sistemi i dobët arsimor, demarkacioni i kufirit të Kosovës me Malin e Zi, anëtarësimi i Kosovës në UNESCO (shprehur vetëm nga të anketuarit nga pakica serbe), fajdet, Asociacioni i Komunave Serbe, etj.

Në fund, kur vjen fjala për kërcënimet e jashtme, qasja e Serbisë ndaj Kosovës është konsideruar si kërcënim më serioz për shumicën e të anketuarve. Gjithashtu kishte referenca drejt kërcënimit që vjen nga grupet ekstremiste të dhunshme globale dhe nga konfliktet. Kriza globale ekonomike është përmendur gjithashtu në mesin e problemeve mbizotëruese.

Në vijim, ky kapitull do të vështroj shkallën në të cilën sektori i sigurisë, (jo)stabiliteti politik dhe situata ekonomike paraqesin një rrezik apo kërcënim potencial ndaj sigurisë kombëtare në Kosovë. Këto çështje i referohen burimeve të rreziqeve dhe kërcënimeve të brendshme drejt sigurisë kombëtare në Kosovë. Përveç kësaj, pjesa në vijim siguron të gjetura lidhur me burimet e rreziqeve të jashtme të cilat i perceptojnë qytetarët si faktor potencial destabilizues si dhe kërcënim potencial drejt sigurisë së Kosovës. Këto kërcënime përfshijnë konfliktet ndërkombëtare

në Siri dhe Irak, ekonominë globale, çështjet shëndetësore, si dhe ngjarjet e fundit që kanë të bëjnë me refugjatët e Sirisë.

Prandaj, pikat e fokusit të këtij kapitulli janë perceptimet publike drejt sigurisë kombëtare:

- Kërcënimet dhe rreziqet e brendshme karshi sigurisë kombëtare;
- Kërcënimet dhe rreziqet e jashtme karshi sigurisë kombëtare;

## 2.1. Kërcënimet e brendshme karshi sigurisë kombëtare

Rezultatet e anketës tregojnë se qytetarët e Kosovës perceptojnë një varg të madh të rrezikut të brendshëm dhe të sfidave që nënkuptojnë potencial për të destabilizuar ambientin politik dhe të sigurisë. Papunësia dhe kushtet e dobëta ekonomike paraqesin sfidat kryesore të brendshme.

Rreth 97% e të anketuarve e shohin papunësinë si kërcënim për sigurinë e Kosovës. Pra, siguria në këndvështrimin tradicional dhe kohezioni social gradualisht po shëndërrohen si shqetësime dytësore për kosovarët e zakonshëm. Ata konsiderojnë se është pikërisht niveli i lartë i papunësisë shkaktar i shqetësimeve të tjera sociale të tilla si rritja e numrit të krimeve ordinere dhe aktivitete të tjera keqbërëse që përfshijnë në veçanti grupe të të rinjve, të cilët nuk kanë perspektivë të ndritshme në shoqërinë e tyre aktuale. Në të vërtetë, shkalla e lartë e papunësisë së bashku me paqëndrueshmërinë e vazhdueshme politike dhe nivelin e lartë të korrupsionit kanë çuar drejt nivelit të ulët të besimit të qytetarëve ndaj qeverisë. Një nga pasojat që rrjedhin drejt nga të gjitha këto çështje është numri i madh i migrimit ilegal i qytetarëve në kërkim të një jete më të mirë jashtë vendit. Qytetarët gjithashtu frikohen se ky nivel i lartë i papunësisë shumë lehtë mund të kthehet në një revoltë sociale me pasoja të paparashikuara. Prandaj, numri i madh i qytetarëve që konsiderojnë papunësinë si sfidën kryesore të sigurisë, nuk është diçka që duhet të injorohet nga institucionet e Kosovës, nga mediet dhe nga shoqëria civile. Në mënyrë më specifike, kjo duhet të merret me një alarm nga të gjitha politikatat institucionale që adresojnë çështje të tilla.

Sidoqoftë, për ta adresuar papunësinë si një çështje është thellësisht e lidhur me adresimin e çështjes së dytë më shqetësuese të qytetarëve sa i përket kërcënimeve dhe rreziqeve të brendshme e që është korrupsioni. Rreth 95% e totalit të anketuarve perceptojnë korrupsionin si një fenomen kërcënues që në mënyrë të vazhdueshme e fundos Kosovën. Me anë të këtyre përgjigjeve, qytetarët edhe një herë rikonfirmojnë se deri më tani janë institucionet shtetërore kanë ndërmarrë fare pak hapa për të zvogëluar nivelin e korrupsionit në Kosovë e që tregon se nuk ekziston vullnet i mjaftueshëm i qeverisë për të ngritur përgjegjshmërinë e zyrtarëve shtetëror që minojnë jo vetëm rritjen ekonomike, por gjithashtu edhe situatën e sigurisë dhe qeverisjen e mirë.


Në ndërkohë, qytetarët kanë shprehur po ashtu se edhe niveli i lartë i krimit është një brengë e cila i shqetëson ata. Sipas të anketuarve, krimi i organizuar është kërcënim i tretë më shqetësues i brendshëm i cili e kanos sigurinë e Kosovës. Më saktësisht, 92 përqind e tyre kanë deklaruar se krimi i organizuar paraqet një kërcënim të lartë për Kosovën. Rezultati është pak më negativ krahasuar me vitin e kaluar. Një nga arsyet për këtë është se ka pasur më shumë publicitet për krimin e organizuar të kryer, që ka rezultuar në një masë në ngritje të vetëdijes së të anketuarve. Në anën tjetër për një percepti më të tillë si duket ka ndikuar edhe në nivelin e ulët të besimit ndaj institucioneve shtetërore, pasi që ata mendojnë se këto institucione kanë treguar performancë të dobët në luftimin e krimit të organizuar në Kosovë.

Mungesa e stabilitetit politik dhe vetë ngërçi politik është konsideruar nga 90% e të anketuarve si një çështje e rrezikut të lartë për sigurinë e përgjithshme në Kosovë. Krahasuar me botimet e mëparshme të BKS, numri i të anketuarve që deklarojnë se paqëndrueshmëria politike është duke paraqitur një kërcënim të lartë, është rritur me 16%. Siç u përmend më parë, perceptimet mbi këtë çështje janë të ndikuara nga ngërçi politik i cili pak a shumë është ende në vazhdim e sipër. Perceptime të tilla në mënyrë të veçantë janë shkaktuar edhe nga zhvillimet e fundit në Kuvendin e Kosovës të shtyra nga mosmarrëveshjet e thella ndërmjet partive në pushtet dhe opozitës për çështje të caktuara që kanë rezultuar në pamundësinë për të mbajtur seanca të rregullta në Kuvend. Sipas perceptimeve të qytetarëve, këto akte janë duke u kryer për interesa private dhe partiake dhe kanë shprehur shqetësime të thella në lidhje me (pa)gatishmërinë politike në zgjidhjen e situatës aktuale.

Një tjetër shqetësim i shprehur nga qytetarët e Kosovës ishte izolimi. Rreth 77% e të anketuarve konsideruan se izolimi i Kosovës, duke iu referuar pamundësisë së qytetarëve të Kosovës për të udhëtuar në vendet evropiane për shkak të mungesës së marrëveshjes për liberalizimin e vizave, është një kërcënim serioz për Kosovën. Qytetarët theksuan se rritja e fundit e refuzimit të vizave është vetëm duke kontribuar në rritjen e migrimit dhe azil kërkimit. Shqetësimet kryesore në lidhje me këto çështje janë të lidhura, sipas të anketuarve, me shkallën e lartë të papunësisë, varfërinë, çështjet sociale, pakënaqësinë me institucionet shtetërore, etj. Përveç kësaj, të anketuarit shprehën shqetësime serioze në lidhje me rikthimin e këtyre shtetasve, përkatësisht kapacitetet e institucioneve të shtetit për të riatdhesuar dhe më tej për të marrë masa për të ndihmuar këta qytetarë për të zgjidhur çështjet e tyre financiare dhe ekonomike dhe për përmirësimin e situatës ekonomike në përgjithësi.

Destabilizimi në veriun e Kosovës është një çështje tjetër, për të cilin qytetarët e Kosovës kanë shqetësime. Shqetësimet e qytetarëve të Kosovës mbi këtë pjesë të territorit të Kosovës janë futur pak nën hije nga ngjarjet e tjera politike në kryeqytet. Megjithatë, rezultatet e studimit të edicionit aktual tregojnë se 70% e të anketuarve e kanë konsideruar situatën në pjesën veriore të vendit si një sfidë që ka një potencial të madh për të destabilizuar situatën e sigurisë në Kosovë. Kjo tregon se dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë nuk pati ndikim pozitiv të pritur për qytetarët e zakonshëm, kur është fjala për përmirësimin e marrëdhënieve ndërmjet dy palëve. Në anën tjetër, 17% e të anketuarve perceptojnë se mund të ketë një rrezik, në një farë masë, nga pjesa veriore e Kosovës, ndërsa pjesa e mbetur (13%) e të anketuarve nuk perceptojnë ndonjë rrezik nga asnjë lloj përshkallëzimi të situatës në pjesën veriore të vendit.

Në krahasim me llojet e tjera të kërcënimeve, qytetarët e Kosovës nuk duket të jenë shumë të shqetësuar në lidhje me fatkeqësitë natyrore siç janë zjarret, vërshimet, rrëshqitjet e tokës dhe rreziqet e ngjashme. Edhe pse Kosova është e prirë për fatkeqësitë natyrore, të anketuarit nuk duket të jenë të shqetësuar për këto lloje të rreziqeve dhe kërcënimeve në mjedis. Janë 42% e atyre që i shohin katastrofat e tilla si një kërcënim, 26% e tyre i shohin ato disi si një kërcënim, ndërsa 31% e tyre nuk i perceptojnë katastrofat e tilla natyrore si një kërcënim. Shqetësimet e tilla të vogla për këto lloje të kërcënimeve, në krahasim me të tjerat, me shumë gjasa mund të vijnë nga mungesa e informacionit të duhur dhe mungesa e vetëdijes për seriozitetin dhe pasojat e rreziqeve të tilla që mund të paraqesin. Pasi që kjo çështje nuk ka qenë shpesh në diskursin publik, të anketuarit duket të mos kenë ndonjë mendim të fortë në këtë drejtim, pasi ishte e qartë edhe gjatë anketimit se shumë prej tyre kërkuar shpjegime më të detajuara në lidhje me këto çështje.

**Figura 13: Rreziqet kryesore të brendshme të perceptuara nga qytetarët e Kosovës**

## 2.2. Kërcënimet e jashtme karshi sigurisë kombëtare

Të anketuarit në përgjithësi kanë treguar mungesë të besimit ndaj institucioneve shtetërore dhe si rezultat, perceptimet e tyre ndaj kapaciteteve të institucioneve të Kosovës për të krijuar siguri nuk vlerësohen shumë. Ngjashëm me mosbesimin e tyre të përgjithshëm në institucionet shtetërore për të mbrojtur qytetarët e saj nga kërcënimet e brendshme, të anketuarit kanë ndarë pikëpamje të ngjashme për institucionet shtetërore, kur bëhet fjalë për (pa) aftësinë e tyre, për të siguruar të mirën publike të sigurisë nga rreziqet e jashtme.

Ngjashëm me rezultatet e anketave të vitit të kaluar, çështjet që kanë të bëjnë me ISIS dhe pjesëmarrjen e qytetarëve të Kosovës në konfliktet jashtë vendit vazhdojnë të paraqesin një kërcënim dhe rrezik për sigurinë kombëtare.

Sipas shumicës së të anketuarve, kërcënimi kryesor i jashtëm për sigurinë kombëtare është i ashtuquajti Shteti Islamik (i njohur si ISIS). Në terma statistikore, në përgjithësi 76% e të anketuarve perceptojnë ISIS si kërcënim serioz edhe ndaj sigurisë kombëtare të Kosovës. Vlen të përmendet se opinionet e qytetarëve janë dukshëm të ndikuara nga ajo që është duke u servuar atyre nga mediet e që japin shifrat se mbi 300 qytetarë të Kosovës (nga 2012-2015) marrin pjesë në konfliktin në Siri dhe Irak. Shqetësimi kryesor i paraqitur nga të anketuarit është aftësia e rekrutuesve për të përhapur ekstremizëm të dhunshëm dhe për të rekrutuar njerëz për një konflikt të huaj në Lindjen e Mesme. Në ndërkohë, me argumente të ngjashme të përdorura, 57% e të anketuarve konsiderojnë konfliktet ndërkombëtare në Siri dhe Irak të jenë një kërcënim, ndërsa vetëm 27% kanë thënë se ky konflikt nuk do të ndikojë drejtpërdrejt Kosovën.

Derisa perceptimi drejt ISIS dhe kërcënimit të tij ndaj Kosovës janë të lartë, perceptimi drejt refugjatëve të Sirisë duket të jetë pak më pozitiv. Numri i refugjatëve të luftës civile në Siri, të cilët kanë braktisur vendin e tyre, sipas Komisionarit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR) ka kaluar katër milion. Duke pasur parasysh këtë fakt, edhe pse 45% e të anketuarve kanë perceptuar arritjen e refugjatëve si një kërcënim, frika e tyre kryesore ishte e bazuar në infiltrimin potencial të anëtarëve të ISIS ndërmjet refugjatëve, me qëllim që të rekrutojnë të rinjtë në Kosovë apo ndoshta edhe të kryejnë akte terroriste këtu. Në anën tjetër, 17% e të anketuarve kanë perceptuar këtë të jetë disi me rrezik, ndërsa 37% e tyre nuk kanë perceptuar asnjë rrezik nga refugjatët sirian. Grupi i fundit i të anketuarve ndajnë më shumë simpati për refugjatët duke pasur parasysh se vetë kosovarët njëherë ishin detyruar ta braktisnin vendin e tyre. Grupi i të anketuarve madje shkoi edhe më tej duke e pranuar se ka nevojë të shfaqet solidaritet ndaj tyre dhe se ata do të ofronin edhe ndihmë, edhe pse ata e dinë se kapacitetet e Kosovës për të pranuar refugjatë janë të vogla.


Serbia vazhdon të perceptohet si një sfidë e jashtme e sigurisë për të anketuarit e Kosovës. Duke pasur parasysh qasjen e Serbisë ndaj Kosovës, të anketuarit perceptojnë Serbinë si aktori i dytë më kërcënues ndaj Kosovës. Rreth 66% e të anketuarve e perceptojnë qasjen e Serbisë ndaj Kosovës të jetë kryesisht e rrezikshme; ndërsa 12% e tyre besojnë se qasja e Serbisë ndaj Kosovës është e rrezikshme vetëm deri në një masë. Pjesa tjetër e të anketuarve (22%) nuk perceptojnë ndonjë rrezik imediat nga Serbia. Krahasuar me edicionin e vitit të kaluar të BKS, ata të cilët e perceptuan Serbinë si kërcënim ka rënë prej 6% të pikëve, e që është në linjë me botimet tjera të BKS më 2013, 2012 ku shifrat lidhur me qasjen e Serbisë kanë qëndruar në mes të 60% dhe 70%. Perceptimet e të anketuarve në këtë kuptim kryesisht bazohen në qasjen e përgjithshme të Serbisë ndaj Kosovës.

Ekonomia globale (recesioni, rënia e remitancës) janë perceptuar si një kërcënim tjetër i sigurisë për 63% e të anketuarve, të pasuar nga 21% të atyre që e perceptojnë këtë pak a shumë me rrezik, dhe 13% të tyre nuk perceptojnë shumë rrezik nga ekonomia globale. Edhe pse ekonomia globale dhe tregtia kanë qenë brenga kryesore për pjesën më të madhe të vendeve evropiane dhe të vendeve tjera ekonomisht të fuqishme, qytetarët e Kosovës, për shkak të izolimit të cilin ata po e përjetojnë, kanë shfaqur më pak brengë në këtë kuptim, kryesisht duke argumentuar se rreziku për përkeqësimin e kushteve të ekonomisë së Kosovës është i vogël.

Në fund, 60% e të anketuarve kanë shfaqur brengë lidhur me përhapjen e viruseve epidemike me potencial global në Kosovë; 20% e tyre e kanë perceptuar këtë disi me rrezik; ndërsa një tjetër 19% e kanë perceptuar këtë si të parrezikshme. Në përgjigje të kësaj pyetjeje, të anketuarit janë ndërlidhur me aftësitë e ulëta mjekësore të qendrave mjekësore kompetente të Kosovës, dhe pamundësinë e tyre të adresojnë katastrofat madhore shëndetësore.



**Figura 14: Rreziqet kryesore të jashtme të perceptuara nga qytetarët e Kosovës**



---

## BIBLIOGRAFIA

### Burimet Primare:

1. Baza e të dhënave të hulumtimit të Barometrit Kosovar të Sigurisë, Edicioni 2015. Hulumtimi është realizuar nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë gjatë periudhës 21 - 30 tetor 2015
2. Barometri Kosovar i Sigurisë 2014 Raporti i Edicionit të Rregullt Vjetor, publikuar nga QKSS, 16 dhjetor 2014
3. Fokus grup i organizuar nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë me hulumtuesit e terrenit të Edicionit të Barometrit Kosovar të sigurisë 2015, 16 nëntor 2015

### Burime të tjera:

- Deutsche Ëelle, Artikull i lajmeve: Një sulm eventual terrorist i parandaluar në Prishtinë, 25 dhjetor 2014, <http://ëëë.dë.com/sq/pengohet-nj%C3%AB-sulm-eventual-terrorist-n%C3%AB-prishtin%C3%AB/a-18152832?maca=alb-rss-alb-polballkani-3242-rdf>
- Deutsche Ëelle, Artikull i lajmeve: Aferat e Dyshuara Korruptive në EULEX Zbehin më tej Besimin e Qytetarëve të Kosovës te Institucionet e Drejtësisë, DË, 4 nëntor 2014, <http://ëëë.dë.com/sq/dyshimet-p%C3%ABr-afëra-korruptive-n%C3%AB-eulex-zbehin-besimin-te-organet-e-drejt%C3%ABsis%C3%AB-n%C3%AB-kosov%C3%AB/a-18038448>
- Lajm.net, Raport i lajmeve: Aksion i Madh Policor: 39 Policë dhe 9 Doganierë arrestohen për korrupsion dhe ryshfet, 15<sup>th</sup> June 2015, <http://lajmi.net/aksion-i-madh-policor-arrestohen-39-police-dhe-9-doganierë-per-mitmarrje-dhe-korrupsion/>
- Reporter.al, Raport i lajmeve: Konfrontime të dhunshme ndërmjet protestuesve dhe policisë në Prishtinë, 27 janar 2015, <http://ëëë.reporter.al/galeri/perleshje-te-dhunshme-mes-protestuesve-dhe-policise-ne-prishtine-fotogaleri/>
- Zëri i Amerikës, Artikull i lajmeve: Policia e Kosovës arreston 5 persona të dyshuar për terrorizëm, 17 korrik 2015 <http://ëëë.zeriamerikes.com/content/kosovo-police-terrorism/2857719.html>

Katalogimi në botim – **(CIP)**

Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

351.746.1(496.51)

Barometri Kosovar i Sigurisë / interpretuesit e të dhënave Mentor Vrajolli, Sofije Kryeziu – Edicioni i pestë . – Prishtinë: Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, 2015. - 28 f.: ilustr. me ngjyra; 24 cm.

Bibliografia : f. 26

1. Vrajolli, Mentor 2. Kryeziu, Sofije

**ISBN 978-9951-679-31-2**

ISBN 978-9951-679-31-2



9 789951 679312

[www.qkss.org](http://www.qkss.org)